



	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA	
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TETO ZA RAZMATRANJE NABAVKI		
Nr/Br.	04/17	
Datë/Datum.	23.02.2017	
PRISHTINË - PRIŠTINA		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 04/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Blerim Dina - Kryetar, z.Tefik Sylejmani - Referues, z.Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, kundër AK-/Korporata Energetike e Kosovës sh.a, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale” me nr prok:“16/016/111”, më datën 10.02.2017 mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, pjesërisht si e bazuar ankesa e OE “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale” me nr prok:“16/016/111”, iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energetike e Kosovës sh.a/.
- II. **Vërtetohet**, vendimi i AK-së /Korporata Energetike e Kosovës sh.a/, për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale”, me nr prok:“16/016/111”.
- III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.
- IV. Operatorit ekonomik ankues OE “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale” me nr prok:“16/016/111”, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar e bazuar.
- V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pikë 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit

të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:28.07.2016 Hapja e ofertave është bërë me dt:11.08.2016, ku kanë marr pjesë katër operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:29.12.2016, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “NPT VALFRIGO” - Pejë.

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Lidhur me kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, Autoriteti Kontraktues me dt:30.12.2016 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Operatori ekonomik “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 06 janar 2017 me nr. 04/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale” me nr prok:“16/016/111”, duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 28 paragrafi 4,5,6 dhe 9 i LPP-së –Specifikimet/teknike
- Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së –Ekzaminimi, vlerësimi dhe Krasimi i Tenderëve
- Neni 72 paragrafi 2 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 27 janar 2017, propozon që aktiviteti i prokurimit me titull “Furnizim, montimi dhe lëshimi në punë i klimave industriale” me nr prok:“16/016/111” iniciuar nga autoriteti kontraktues Korporata Energetike e Kosovës, të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë të aprovojë si të bazuar Operatori ekonomik ankues “NTP PRIMUS Engineering” - Prishtinë, me datë: 30 janar 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me datë: 30 janar 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.02.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhëni e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues “Primus Engineering” ka deklaruar: “Me qenë se në këtë rast ka të bëjë vetëm me një pikë për sasinë e ajrit që liron njësia brendshme, ka të bëjë me një klimë që është e ngjashme me gjitha Air Condiioneret komersial për fotoje dhe ngrohje, edhe kjo pajisje ka tri shpejtësi, sasia ajrit që ajo qarkullon brenda ambientit ku ajo punon. Duke marr parasysh që sasia maksimale është 3000 metra kub ndërsa minimale është 2000 metra kub, e dyta shpejtësi ka 2500 metra kub. Është fakt se dokumentacioni teknik i kërkuar nga KEK ka qenë 2500 +- % e dhenë. Duke pas parasysh se shpejtësinë e tretë mundet shumë lehtë operatori e komandon atë klimë e me e ulë në shpejtësinë e dytë, dhe shpejtësinë e parë, ne kemi dhënë tri mundësitë, dhe nëse kjo nuk pëlqen atëherë mundet prej servisit të autorizuar ku kemi autorizimin ne mund të eliminojmë shpejtësinë e tretë në formë individuale. Opsioni dytë ka qenë që prej prodhuesit me kërkua që në softuerin që ka pajisja në fabrikë të eliminohet shpejtësia tretë duke mos shkaktuar kurrfarë ndryshimi të pajisjes teknike mund të dëmtoj pajisjen. Në fund për te elaboruar kemi kërkuar nga Fakulteti Makinerisë të bëjë analizë të pajisjes, dhe ekspertët profesorët e nderuar kanë bërë analizë dhe na kanë dhënë një test të kësaj pajisje që e kemi dokumentin dhe kanë vërtetuar se kjo pajisje plotëson këto kondita dhe sugjerimi tyre pasi këto pajisje kanë me punu në ftohjen e pajisjeve tjera në ekskavatorët e nxjerrjes së thëngjillit edhe shpejtësia tretë ndikon në ftoje më të shpejtë të pashijes, pasi këto pajisje edhe sipas përvojës tonë do punojnë 24 12 muaj gjatë vitit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: “Ne mospajtimin tonë e kemi dhënë me përgjigje në ekspertizën e ekspertit teknik me datë 30.01.2017 të cilën eksperti ka shkel vendimin e OSHP 367/16 të datës 330.11.2016. Kjo është për shkak se i njëjti ankues tanë në njoftimin paraprak për dhënie të kontratës ka deklaruar për të njëjtin kriter teknik që nuk e ka përmbrushur tanë ky ankues dhe “OE ankues ka thënë se nuk është ekuivalent me kërkeshën” gjithnjë duke u bazuar që vet pala ankuese thotë “OE që është i shpallur për dhënie të kontratës herën e parë nuk plotëson këtë kërkeshë”. Tani del OE ankues dhe arsyeton veten për këtë gabim ndërsa vendimi i OSHP pikërisht për këtë pikë nga pikat për arsyet përfundimtarët. Vendimi i kaluar e ka eliminuar OE të rekomanduar për kontratë pikërisht për këtë pikë. Kërkesa jonë ka qenë 2300 metra kub me +- 10%, ndërsa OE ankues startin e ka ofruar me 3000 metra kub. Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese/teknike ka deklaruar: “Procedurat paraprak e un nuk kam qenë e angazhuar”. Në njoftimin e AK në letër standarde për arsyen e eliminimit nga AK-KEK kundrejt Primus për pozicionin 4 montim i klimës industriale me kapacitet të rrjedhjes së ajrit 2300 +- % tolerancë. Në aspektin teknik kjo klimë plotëson kushtet sepse OE ankues ka ofruar me tri mundësi pajisjen. Kjo pajisje është ofruar me Remote Control, dhe nuk është pjesë që montohet nuk e pengon procesin. Në rastin konkret pajisja ofruar nuk pengon në asnjë mënyrë performancat dhe ka mundësinë të veproj brenda parametrave të kërkua nga AK.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: “Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe kërkojmë nga panelit që të kthej lëndën në Rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK deklaroj “Për njëjtin kriter që po diskutojmë OE i rekomanduar më herrët është eliminuar, dhe dallimi në çmim mes këtyre dy OE-ve është i madh.

Andaj kërkojmë ng panelit të vërtetoj vendimin për anulim të AK-së dhe nëse AK ka interes lëndën ta ritenderoj.

Në fjalën përfundimtare ekspertja shqyrtuese/teknike deklaroj: "Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në ekspertizë".

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit më arsyetimin se nuk ka asnje ofertues të përgjegjshëm dhe njëkohësisht ka sqaruar se operatori ekonomik ankues "NTP PRIMUS Engineering" - Prishtinë ka ofruar me variante për pozicionin 4 ku është kërkuar "air conditioners 60,000 Btu/h DC Inverter-Air flow 2300 + - 10% m³/h, ndërsa OE ankues ka ofertuar me Air flow 300 m³/h. Paneli shqyrtues konstaton se ky operator ekonomik është shpallur i papërgjegjshëm me të drejtë nga ana e autoritetit kontraktues, pasi që në pikën 4.1 të FDT-së është shënuar që variantet nuk do të autorizohen. Prandaj pretendimet e OE ankues se janë bërë shkelje të nenit 28,59 dhe 72 të LPP-së janë të paqëndrueshme, pasi që kërkesat për svarime shtesë mund të kerkohen kur ka dilema dhe paqartësi në lidhje me ndonjë dokument e jo kur ofertohet me variante, përderisa variantet nuk janë lejuar nga ana e autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues konstaton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në harmoni me nenin 44.7 pika (ii) i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në diapositiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – "Korporata Energetike e Kosovës"
- 1x1 OE – "NTP PRIMUS Engineering" - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së
- 1x1 Për publikim në eeb-faqe të OSHP-së.